



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23 DHJETOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23. DECEMBRA 2016. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Budžetu Republike Kosova za 2017. god.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Vazhdojmë seancën,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Jemi tashmë në vazhdimin e seancës plenare të 23 dhjetorit 2016.

I hap punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të caktuar me vendim të seancës plenare, të datës 22 dhjetor 2016.

Fillojmë me të vetmen pikë:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme në pajtim me vendimin e Kuvendit, datë 22 dhjetor 2016, ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, kërkoj falje në qoftë se kam gabuar.

Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme në pajtim me vendimin e Kuvendit, datë 22 dhjetor 2016, ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e përkrahura nga Komisioni FunkSIONAL.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Deputetë,

Komisioni ka punuar me përkushtim të jashtëzakonshëm dhe ka shqyrtuar gjithsej 91 kërkesa, prej të cilave 59 kërkesa të agjencive të ndryshme buxhetore dhe 32 kërkesa të deputetëve në formë të amendamenteve dhe nga kjo ka bërë 60 amendamente, prej të cilave 28 amendamente janë të komisionit, që përmbajnë gjithsej 145 ndryshime buxhetore.

Zoti kryetar, dua t'i falënderoj së pari anëtarët e komisionit, të pozitës e sidomos ata të opozitës për një bashkëpunim dhe për votën e tyre në komision dhe kam obligim moral të falënderoj stafin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ekipin e Ministrisë së Financave që kanë punuar me këtë përkushtim.

Meqenëse ka qenë punë kaq intensive, zoti kryetar dhe deputetë të nderuar, kërkoj ndjesë për dy gabime, të cilat janë bërë.

Një, te amendamenti 10, pika 1.11, duhet të fshihet, sepse kemi përsëritje, dy herë është shkruar. 1.11 duhet të fshihet, sepse e njëjta është në 1.12 dhe për këtë tani të bëhet rregullimi i numrit rendor. Edhe një gabim na ka shpëtuar, duhet të jetë në formë të amendamentit, ka të bëjë me nenin 11, të paragrafit 5 të tekstit të ligjit e që ka të bëjë me shumën prej 9.6 milionë për RTK-në, të bëhet 11 milionë, është në pjesëtim tekstual të ligjit, sepse amendamenti 21 është në rregull. Domethënë, shuma prej 9.6 milionë bëhet 11 milionë te neni 11, paragrafi 5 që ka të bëjë me RTK-në, këto janë dy plotësime, të cilat kisha dashur të evidentohen dhe të përmirësohen.

Nga ana tjetër, zoti kryetar, kisha kërkuar që ndryshimet, 28 amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa të votohen në pako, duke përfshirë edhe këto dy përmirësime, sepse përmbajnë një sistem të tërë dhe janë të ndërlidhura, kështu që nuk ishte dashur të bëjmë një ndërhyrje te to, sepse janë të balancuara, po te amendamentet e tjera, të cilat janë të deputetëve, të jap një sqarim që shumicën e këtyre amendamenteve të deputetëve komisioni i ka trajtuar, i ka aprovuar, po i ka shndërruar në amendamente të komisionit, shumica janë të përfshira, po ashtu edhe disa kërkesa të opozitës janë përfshirë.

Prandaj, i kisha lutur deputetët që amendamentet e deputetëve të mos përkrahen, sepse shumica prej tyre janë të përfshira në amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryetar! Po, zonja Safete Hadërxhonaj e ka fjalën. Ndërkohë unë kur ta bëj propozimin për votim do të shkoj amendamentet që janë propozuar nga komisioni, me vërejtjet të cilat i ka paraqitur kryetari i komisionit. Në qoftë se ka edhe ndonjë vërejtje nga komisioni, nga anëtarët e komisionit, pastaj futen të gjitha menjëherë e votohen.

Ndërsa amendamentet e deputetëve shkojnë individualisht, secila në votimin elektronik, dhe kanë mundësi deputetët të llojnë për secilin amendament. Urdhëro, zonja Hadërgjonaj!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Kam edhe një plotësim ndryshim, qenka lëshuar një gabim te emri i një projekti. Është fjala për amendamentin 7, pika 1.5 nën programin Arritjet sportive, me kod 80200 në tabelën 3.2 në kategorinë “shpenzime kapitale” shtohet projekti i ri Salla Sportive në Zhur, nuk është salla sportive, por është Stadiumi në Zhur. Edhe ky përmirësim kërkoj të bëhet, sepse ka rrëshqitur si gabim.

KRYETARI: Faleminderit! Komisioni Funkcional i ka 28 amendamente, të cilat i ka paraqitur kryetari i komisionit dhe zëvendëskryetarja e komisionit. Në qoftë se e kemi pajtimin e seancës, shkojmë në votimin e tyre në tërësi, e pastaj shkojmë një nga një për secilin amendament.

A ka dikush ndonjë deklaram për këto? Nuk ka!

Aktualisht në sallë janë 84 deputetë. Do të shkojmë në votim elektronik.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e amendamenteve 1 deri në 28, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, me vërejtjet dhe korrigjimet, të cilat i kanë paraqitur kryetari i komisionit dhe zëvendëskryetarja e komisionit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar në mënyrë elektronike, një deputet me dorë. Cila është vota juaj? Për. 68 deputetë në mënyrë elektronike, plus një me dorë janë për, dy, më fal, atëherë 76 deputetë kanë votuar. Gjithsej janë 70 deputetë për, 68 në mënyrë elektronike dhe dy me dorë, 3 janë kundër, 3 janë abstenime. Kalojnë 28 amendamentet.

Tani kërkoj vëmendjen tuaj për secilin amendament, edhe propozuesi mund të bëjë vetëm përshkrimin e saj dhe të kërkojë përkrahje nga kolegët deputetë.

Do të shkojmë me rend, Daut, një nga një. Urdhëro, Daut!

DAUT HARADINAJ: Ndoshta kryetari i komisionit ishte dashur të na shpjegojë se po shoh, për shembull, që ka një shpërputhje mes amendamenteve pa përkrahjen e komisionit. Ndërsa, në anën tjetër, në tabelën buxhetore ku i ka paraparë në kuadër të ministrive, domethënë, a mund të na shpjegosh çka nënkupton kjo, se unë nuk po e kuptoj qartë, ndoshta do të ishte me rëndësi.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i komisionit, a ka nevojë? Urdhëro, kryetari i komisionit, zoti Naser Osmani!

NASER OSMANI: Unë u mundova të jem shumë i artikuluar lidhur me amendamentet që i kanë parashtruar deputetët apo komisionet.

Ne i kemi trajtuar dhe ato që i kemi trajtuar, i kemi shndërrua si amendamente të komisionit. Prandaj, shumica e amendamenteve që kanë bërë deputetët janë si amendamente të aprovuara të komisionit, jo të deputetëve, sepse kemi bërë një ndryshim të vogël në shuma që janë kërkuar. Përderisa nuk e kemi aprovuar 100% domethënë kërkesën e deputetëve ne e kemi shndërruar si amendament të komisionit.

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë drejtpërdrejt për secilin amendament.

Jemi te amendamenti 29. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport nuk e ka përkrahjen e Komisionit Funkcional. Kush e kërkon fjalën nga komisioni. Atëherë shkojmë drejt në votim të amendamentit 29, në mënyrë elektronike votojmë. Zoti Bulliqi e ka kërkuar fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e paraqita edhe më herët çështjen e nevojës së ndërtimit të Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore. Edhe tash këtu në praktikë po del që është i vetmi amendament që është propozuar nga ana e Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji dhe i cili faktikisht është refuzuar.

Unë isha edhe në komision, e arsyetova rëndësinë e ndarjes së këtij buxheti shtesë lidhur me këtë projekt, por komisioni nuk e pa të rrugës të bëjë një ndryshim në shumën e buxhetit të përcaktuar.

Është viti i dytë me radhë që ky projekt mbetet me këto 200 mijë euro, edhe faktikisht po mbetet si projekt, i cili nuk është me rëndësi.

Unë ju them që është shumë me rëndësi, sepse në këtë fakultet janë mbi 7000 studentë dhe është i vetmi fakultet në Universitetin e Prishtinës, i cili faktikisht nuk ka objekt të vetin sot e kësaj dite,

Ju ceka edhe më herët që kemi projekte që për herë të parë janë futur në këtë vit, nuk kanë qenë vitin e kaluar dhe kanë shkuar me miliona shuma të mjeteve.

Prandaj, edhe një herë kërkoj nga të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës që këtë shumë, të cilën e ka kërkuar në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji për Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore të ndahet një shumë e buxhetit e cila është kërkuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë ministri do të përgjigjet.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Më lejoni të sqaroj që për këtë projekt për objektin e Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore janë të parapara 1.3 milionë euro, 200 mijë vitin e ardhshëm, janë 350 mijë në vitin 2018 dhe pjesa tjetër është në vitin 2019. Pra, nuk ka asnjë pengesë teknike, as juridike që në fillim të vitit të ardhshëm të lidhet kontrata për ndërtimin e këtij fakulteti në total prej 1.3 milionë eurosh dhe varësisht prej progresit që bëhet në ndërtimin e këtij objekti. Ne me rishikim ose në fund të vitit mund t'i qesim mjete sa të ketë nevojë për ta ndërtuar me kohë këtë fakultet. Pra, është i buxhetuar plotësisht për tre vjetët e ardhshme.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bulliqi e dëshiron prapë fjalën, edhe zoti Nait Hasani nga komisioni po e shoh që e ka kërkuar.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Do të isha pajtuar plotësisht me këto që i thotë ministri, por me të njëjtën shumë buxhetore ka qenë edhe në vitin e kaluar dhe nuk është bërë asgjë. Prandaj, po mbetet prapë edhe këtë vit me të njëjtën shumë buxhetore për të mos u bërë asgjë. Prandaj, unë edhe një herë kërkoj që kjo çështje të shqyrtohet dhe të merret me seriozitet nga ana e kolegëve deputetë dhe të ndahet shuma buxhetore e kërkuar në mënyrë që të fillojë puna në vitin vijues në objektin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

KRYETARI: Zoti Hasani, fjala për ju! Nga Komisioni për Sport është, kur është nga deputeti, flet vetë deputeti, aktualisht e kemi një amendament nga komisioni, ta keni parasysht.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit edhe prej kolegut, Shpejtim, që e ngriti çështjen.

Komisioni ka mbajtur mbledhje dhe ka kërkuar që t'i ndahet ky buxhet pikërisht për ndërtimin e Fakultetit të Shkencave. I vetmi fakultet që e ka një gjendje të mjerueshme.

Kërkesa jonë është që tre vjet duke e përcjellë këtë buxhet për këtë fakultet dhe asnjëherë nuk është bërë asnjë hap për t'u ndërtuar. Nëse nuk rregullohet, këto para nuk shkojnë askund, nuk humbin, janë pjesë e tepricës. Ne po kërkojmë që t'i ndahet buxheti, ta votojmë buxhetin për këtë amendament për Fakultetin e Shkencave dhe Fakulteti i Shkencave të fillojë ndërtimin. Ndryshe, me këto që është bërë, unë po pajtohem me ministrin që i kemi edhe për tre vjet, por ne ta ndajmë këtë vit, nëse nuk realizohet, ato para shkojnë në suficit dhe i ndahen prapë, mbesin për vitin tjetër, por ta ndajmë buxhetin, i cili do ta mundësojë ndërtimin e Fakultetit të Shkencave.

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në fazën e votimit tani, ky ishte qëndrimi i komisionit, në të njëjtën kohë i ministrit të Financave.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim.

Amendamenti 29. Votojmë tash:

72 deputetë kanë votuar, 26 për, 35 kundër dhe 12 abstenime, do të thotë 73 deputetë kanë votuar. Nuk kalon amendamenti 29.

Amendamentet 30, 31 dhe 32.

A dëshiron të tri përnjëherë, zonja Haxhiu, apo dëshiron një nga një t'i lexosh. Një nga një. Atëherë jemi te amendamenti 30.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Normal se unë kërkoj përkrahjen e deputetëve. Amendamenti 30 është fjala për rrugën Smolicë-Stubëll-Bërjan-Nivokaz, pra që lidh dy komunat, komunën e Gjakovës dhe komunën e Junikut, e shuma që është paraparë në 2019-ën prej 200 mijë euro, tani jemi në vitin 2016 dhe rëndësinë e kësaj rruge e tregova edhe më herët, është e një rëndësie të veçantë dhe tani të presim në 2019-ën të ndahet një shumë. Vërtet secili prej deputetëve e di rëndësinë e kësaj rruge dhe kërkoj nga deputetët që ta përkrahin shumën prej 200 mijë eurosh. Nuk do të thotë që projekti do të përfundojë, sepse projekti kërkon 950 mijë euro, por të fillohen punimet si kërkesë e kamotshme e komunitetit, por edhe e Komunës së Gjakovës. Pra, ju lus që ta votoni këtë amendament për interesin e të gjithë qytetarëve dhe lidhjes që bën ndërmjet dy komunave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim. Jemi në amendamentin 30, të propozuar nga deputetja Teuta Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 69 deputetë, 25 për, 32 kundër, 12 abstenime. Nuk kalon amendamenti 30.

Kalojmë te amendamenti 31.

Zonja Haxhiu, jemi te amendamenti 31.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit 25 deputetëve.

Të nderuar deputetë,

Sinqerisht kërkoj vëmendjen tuaj. Amendamenti 31 është për Kompleksin Memorial “Meja”, masakra më e madhe në Kosovë, e shpallur me vendim të Kuvendit.

Ky kompleks memorial, pos dhimbjes të 374 familjeve që i kanë humbur të dashurit për vetëm dy orë, është kompleksi që i ka të dy besimet, që janë të varrosur, i vetmi në Kosovë, pra qytetarët ende kërkojnë edhe disa të pagjetur, që janë gjithsej 17, që ende nuk janë gjetur, pos plagëve që i kanë familjarët e tyre, pra kërkoj që të keni ndjeshmëri dhe ta votoni amendamentin i cili e kërkon shumën prej 300 mijë eurove, edhe pse ky projekt pra është 1 milion e 200 mijë euro. Por, në vazhdimësi, vit pas viti, në ditën e 27 prillit shkohet nga përfaqësuesit e Qeverisë premtohet dhe asnjëherë nuk u nda një shumë.

Prandaj, edhe një herë ju lus deputetë, para familjarëve që sot pra ta votojmë këtë amendament në shumën e kërkuar prej 300 mijë eurove që të vazhdojnë punimet, sepse ka filluar, por aty është një gjendje tmerruese, në qoftë se sot kaloni andej dhe e shihni çfarë gjendje është.

KRYETARI: Jemi tek amendamenti 31. Deputetja Teuta Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Zonja deputete, ka kaluar amendamenti.

72 deputetë, 71 në mënyrë elektronike, 1 me dorë. 39 deputetë janë për. 20 janë kundër. 13 abstenime. Kalon amendamenti.

Urdhëro, zoti ministër!

Zoti Osmani, kryetar i Komisionit, e ka kërkuar fjalën, ju kisha lutur.

NASER OSMANI: Kryetar!

Të mos hyjmë në situata jo të mira që kanë të bëjnë me harmonizimin apo balancimin e buxhetit ndërmjet të hyrave dhe të dalave.

Këto janë amendamente jo të plota, gjysmë-amendamente. Amendamentet që kërkohen prej deputetëve që të bëhet një projekt dhe nuk tregohet burimi i mjeteve, ju kisha lutur që të mos i hidhni fare.

KRYETARI: Është vërejtje me vend, vetëm se komisioni nuk është dashur t'i sjellë fare në seancë, ky është problemi.

Nuk është dashur t'i sjellë fare në seancë si amendamente të propozuara edhe prej tyre, për arsye se tani në këtë moment unë jam i detyruar të procedoj me këto amendamente, të cilat kanë ardhur, edhe pse s'e kanë pasur përkrahjen e Komisionit Funksional, është obligim i kryetarit të Kuvendit dhe i deputetëve që t'i procedojnë. Ka të drejtë kryetari i komisionit. Urdhëro zoti Gashi, Besa Gaxherri pastaj e ka kërkuar fjalën. Besa Gaxherri e shoh që e tërhoqi fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Nëse amendamenti nuk i ka plotësuar kushtet formal-juridike, komisioni nuk është dashur ta procedojë.

Në momentin që është në procedurë kuvendore, Kuvendi voton dhe vendos, në momentin kur Kuvendi vendos, ai është ligj dhe kryhet kjo punë. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë deri tek amendamentet në fund, por ta keni parasysh - çdo votim i amendamenteve e krijon një situatë të tillë, e cila na vë në pikën zero të punës sonë.

Zonja Gaxherri po insiston prapë. Urdhëro!

BESA GAXHERRI: Jo që po dua të them diçka të re, por ta kemi parasysh: Të gjitha amendamentet e opozitës janë shqyrtuar. Jo të gjitha janë aprovuar ashtu qysh janë kërkuar, por të gjitha janë si amendamente.

Në qoftë se i votojmë dy herë, edhe atë kërkesë dhe këto që i kemi aprovuar, duhet të shkojmë në leximin e tretë. Prandaj, ju lutem, votojini amendamentet që i keni aprovuar në Komisionin e Buxhetit. Përndryshe, ne duhet ta rishqyrtojmë edhe një herë. Çdo amendament që hyn tash jashtë Komisionit të Buxhetit duhet ta shqyrtojmë prapë në leximin e tretë.

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë te amendamenti 32.

Kryeministri i Republikës së Kosovës e ka kërkuar fjalën, zoti Isa Mustafa.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Tash ne do të vijmë në një pozitë të pavoritshme, në qoftë se votojmë pa burime, sepse shtrohet pyetja çfarë buxheti bëjmë ne në qoftë se nuk kemi balancim të buxhetit.

A bëjmë ne ligje a s'bëjmë, edhe ligje duhet të bëjmë mbi bazën e një burimi. Ne ose duhet ta gjejmë dhe të themi se i marrim 300 mijë nga ky burim dhe i japim për këtë, ose duhet ta lëvizim dhe të themi që Buxheti i Republikës së Kosovës nuk është 2 miliardë e 100 milionë, por është 2 miliardë e 100 e diçka milionë, e atë ne nuk e kemi në llogari të buxhetit. Kështu që ju kisha lutur që të kemi kujdes në qoftë se bëjmë ndryshime, të bëjmë ndryshime edhe me lejm të mjeteve, por edhe me burim të mjeteve. Pa burim, ne e kemi vështirë të bëjmë ndryshime.

Prandaj, e kisha lutur Kuvendin që ta korrigjojme këtë vendim, unë e kuptoj që është vendim sensitiv, por komisioni e ka pasur parasysh, ne e kemi harmonizuar për atë sa ka qenë e mundur të harmonizohet, por të hyjmë pa mbulesë e të bëjmë ligj të buxhetit pa mbulesë, unë si kryeministër nuk mund të pajtohem. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në këtë situatë: amendamenti 31, të nderuar kolegë deputetë, e prish balancën e buxhetit, por ai ka kaluar dhe është ligj. Ta keni parasysh!

Ju kisha lutur, nëse e bëni disbalancën e buxhetit, ne pastaj do të ulemi bashkërisht në fund të fundit, por në qoftë se vazhdoni kështu në amendamentet tjera e humbim, megjithëse ne duhet t'ia gjejmë të gjithë vendin për shkak të aspektit njerëzor, rastit të varrezave masive atje. Duhet t'ia gjejmë vendin, në fund të fundit çdo gjë ka zgjidhje.

Vazhdojmë me amendamentin 32. Urdhëro zoti Beqaj!

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Ne i kemi disa amendamente para vetes, të cilat parimisht, edhe pse kanë ardhur nga Komisioni për Buxhet, nuk janë të kompletuara. Unë e kuptoj që kjo është çështje që kur seanca e merr një vendim, ai është ligj. Normalisht për amendamentin 31 nuk kemi më çka të diskutojmë, sepse është i kryer.

Por, i kisha lutur deputetët që ta kenë parasysh që shumë amendamente, të cilat e kanë lëshuar substancialisht buxhetin, janë të evidentuara dhe janë të aprovuara me votimin, të cilin e bëmë më herët.

Normalisht, të gjithë deputetët kanë të drejtë të paraqesin amendamente, por amendamentet që i kemi para vetes nuk e tregojnë asnjëra prej tyre burimin e financimit ku po i merr dhe do të krijojë situatë jo të volitshme dhe realisht po them nëse vazhdohet kështu, sigurisht duhet që të shkohet në lexim të tretë.

Prandaj, unë besoj që do të ishte shumë me rëndësi që ne ta mbajmë buxhetin të balancuar dhe si të tillë ta votojmë edhe në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e dëshironi fjalën edhe një herë? Ministri i Financave, zoti Avdullah Hoti e ka fjalën.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Kryeministri dhe deputeti Beqaj thanë se çdo amendament për të qenë i plotë propozuesi duhet ta japë propozimin ku merren ato mjete, ndryshe ky bëhet ligj në Kuvendin e Kosovës, por askush nuk ka të drejtë ligjore t'i ndërrojë numrat në tabelat e ligjit për ta implementuar këtë amendament pasi të aprovohet komplet Ligji i Buxhetit.

Kështu që ju kisha lutur në raste të tilla duhet dhënë propozimin ashtu si e keni, por jepen propozimin për ndryshim të shifrave, edhe propozimin se ku merren këto mjete për t'i dhënë, prapë ju duhet ta votoni edhe zvogëlimin e buxhetit në një projekt dhe rritjen e buxhetit në projektin tjetër.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë te amendamenti 32. Urdhëro, zoti Haradinaj, fjala është për ju!

DAUT HARADINAJ: E kam shkurt një pyetje për ministrin e Financave: Sa është buxheti që ju e quani kontingjent për investime pa destinim për x-komunat, për ku i keni, kush i vendos? A mund të na thoni ju se sa e keni atë kontingjent buxhetor në kuadër të Ministrisë së Financave?

KRYETARI: Ministri i Financave, është në dëshirën e tij nëse dëshiron të përgjigjet. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Me amendamente është shpërndarë krejt kontingjenti, komplet, zero është. Është lënë gjatë diskutimeve, gjatë dy leximeve në Kuvend kanë ardhur plot propozime prej grupeve parlamentare dhe është shpërndarë nëpër projekte të ndryshme.

Zero është tani, sepse është shpërndarë nëpër projekte konkrete që kanë ardhur prej grupeve parlamentare.

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votimin e amendamenteve tjera, pastaj nga fundi para votimit të tërësishëm të projektligjit diskutojmë edhe një herë.

Amendamenti 32, zonja Teuta Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Urdhëro!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Amendamenti 32, është fjala për rrugën Deçan-Plavë, se sa është i rëndësishëm ky projekt të gjithë deputetët e dinë, prandaj ne e kemi kërkuar shumë prej 1 milioë e 950 mijë euro pasi që sivjet, pra në këtë viti janë ndarë vetëm 50 mijë euro.

Prandaj, kërkoj që shuma e kërkuar prej 1 milion e 950 mijë eurove të votohet nga deputetët.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Ju njoftoj që në amendamentin 8, pika 1.13 - shuma për këtë projekt është bërë 300 mijë euro. Komisioni e ka mbështetur.

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim!

Zonja deputete, a dëshironi ta tërhiqni apo të shkojmë në votim? Në votim, ka insistim, edhe pse është pa përkrahjen e Komisionit Funksional. E thashë, e treta herë është.

Amendamenti 32, i propozuar nga zonja Teuta Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar: 14 për, 54 kundër, 6 abstenime. Nuk kalon.

Amendamenti 33, deputeti Armend Zemaj, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Zoti Zemaj i ke disa amendamente, në qoftë se dëshiron mund t'i vendosësh të gjitha përnjëherë në paketë në votim. Si të dëshironi.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë po e shpjegoj, sepse janë 5 amendamente, një është imi, por 4 janë të Komisionit Legjislacion, të cilat janë bërë të propozuara nga unë. Domethënë, në emër të komisionit, edhe pse këtu nuk është evidentuar.

Por, më lejoni të theksoj që amendamenti 33 është i bartur te amendamenti 7, paragrafi 1.22, ka ndryshuar shuma, janë pajtuar, është në rregull, ka kaluar. Faleminderit prej komisionit! Domethënë e tërheq.

Amendamenti 34, që është i Komisionit për Legjislacion, ka të bëjë me Ministrinë e Drejtësisë, edhe ky është bartur dhe është miratuar te amendamenti 17. Edhe ky tërhiqet.

Amendamenti 35, tash më lejoni ta shpjegoj po këtë përgjigje duhet ta jap ministrja e Drejtësisë, sepse ka të bëjë me Ligjin për kompensimin e viktimave të krimit, por besoj që ashtu siç biseduam kjo do të jetë kompetencë e Këshillit Gjyqësor dhe ata do ta caktojnë një taksë për implementimin e këtij projektligji. Kështu që ne jemi pajtuar që të tërhiqet.

Amendamenti 36 ka të bëjë me Këshillin Prokurorial, dhe amendamenti 37, edhe këtu është plotësuar një normë. Nuk është e kënaqshme ashtu siç kemi kërkuar, por për këtë pjesë, sidomos deri në rishikim ne jemi pajtuar, sepse është një numër i konsiderueshëm i pozitive që janë futur, kështu që unë jam në rregull me 5 amendamentet e mia. Ato që kanë kaluar kanë kaluar, këto dyja jemi pajtuar që të tërhiqen dhe tërhiqem nga amendamentet në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, koleg deputet!
Atëherë, kemi tërheqjen e amendamenteve 33 deri 37.

Jemi në amendamentin 38, deputetja Duda Balje, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. I ke dy amendamente, zonja deputete, në qoftë se dëshiron!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Amandman 38 povlačim zato što je prošao, zahvaljujem se ministru uvršteni u Ministarstvo za infrastrukturu, i njemu se zahvaljujem. Što se tiče amandmana 39 za snimanje filma, od momenta predavanja ovog amandmana do današnjeg dana imali smo dogovor za ministrom za kulturu, i mislim da će to proći u okviru njegovog budžeta, tako da je i ovaj povlačim, i ujedno se zahvaljujem ministru. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, zonja Duda i tërhoqi amendamentet 38 dhe 39.

Amendamentet 40 dhe 41, deputeti Pal Lekaj vendos vetë a i vendos të dytë përnjëherë, apo ndaras.

PAL LEKAJ: Kryetar!

Vetëm më lejoni që të flasim pak për procedurën. Është për të të ardhur keq që pas shumë viteve Parlamenti i Kosovës mendon që nuk duhet të procedohen amendamentet që i propozojnë deputetët dhe ajo që duhet çdo deputetë ka të drejtë që të propozojë amendamente.

Sa i përket burimit të mjeteve, është Qeveria që duhet të kujdeset dhe ne nuk jemi se në cilat pozicione mund t'i marrin. Prandaj, është kërkesë eksplicite dhe duhet që Qeveria të kujdeset. Sa i përket kësaj kërkesë të qytetarëve të Lugut të Drinit, mendoj që që 18 vjet askush nuk e ka investuar asnjë cent dhe kur e përmend këtë rajon dihet pse e përmendi. Unë mendoj dhe kërkoj nga të gjithë deputetët, që nuk është ndonjë shumë e madhe, të dy projektet janë 230 mijë euro dhe unë mendoj se është në nderin e juaj që të aprovohen këto dy amendamente. Mund të gjendet shuma. E di që sa herë kjo qeveri ka thënë se nuk guxojmë pa e pasur zotimin e të gjitha mjeteve për projekte të kontraktohen, ndërsa tani po del që në mënyrë parciale deri në 50 mijë euro me një projekt që kushton deri në 600 mijë apo 1 milion euro. Kjo prapë po e shkelim Ligjin për prokurimin publik.

Ajo që unë tani po e lexoj amendamentin është: Kërkojmë që të ndahen mjete për fshatin Krushevë e Madhe, lagjja Dodaj, Palushaj, deri te Mark Kolaj me ndërtimin e projektit kapital, asfaltimi i rrugës dhe kanalizimit të ujërave të zeza në gjatësi 2,5 km dhe kanalizimi në gjatësi 1,5 km në masën monetare 170 mijë euro. Prandaj, këta janë përafërsisht 350 banorë me diku 35 shtëpi dhe unë mendoj që ia vlen që të përkrahet dhe nuk është ndonjë shumë kush e di çka, që mos ta përkrahim dhe kërkoj nga kolegët e mi që ta mbështesin këtë amendament.

KRYETARI: Jemi tek amendamenti 40. Deputeti Pal Lekaj pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Ministër, a dëshironi të përgjigjeni më apo... s'ka. Ok! Shkojmë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Deputeti Pal Lekaj, amendamenti 40 pa përkrahjen e komisionit funksional. Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar, 19 për, 45 kundër, 10 abstenime. Nuk kalon amendamenti 40.

Amendamenti 41, përsëri deputeti Pal Lekaj, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

PAL LEKAJ: Sa i përket këtij amendamenti unë mendoj që është e pakuptimtë që edhe të propozohet. I falënderoj deputetët dhe Qeverinë, që kanë kaq kujdes për qytetarët, që 17 vjet nuk është investuar asnjë cent. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Pal, është dashur bile neve që votuam për të na falënderoni, na futët të gjithëve... atëherë, amendamenti 41 është tërhequr. Shkojmë me amendamentin 42, 43 dhe 44. E vendos deputeti Bali Muharremaj pa përkrahjen e Komisionit Funkcional a shkojmë një nga një apo të gjithë bashkë.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar! Amendamenti 42 me përkrahjen e komisionit ka kaluar, domethënë ndërtimi i shkollës në Leshan në dy faza për vitin 2017 dhe 2018, kur janë ndarë 400 mijë euro. Nuk dua ta zgjas më shumë.

Po ashtu, edhe amendamenti 43 për ndërtimin e shtëpisë së kulturës “Ukë Bytyqi” në Suharekë edhe kjo ka kaluar për vitin 2017 janë ndarë 150 mijë ndërsa vazhdon me fazën 2018/2019, nuk kemi nevojë se ka kaluar. Falënderoj kolegët, anëtarët e komisionit. Për hir të opinionit amendamenti 44 kërkoj që për projektin të vendosin deputetët e Parlamentit është memoriali i viktimave civile të datës 26 mars të vitit 1999 të familjes Berisha të ndahen 500 mijë euro, në mënyrë që ky projekt të fillojë realizimin.

Arsyetim: shumë shkurt. Koncepti ideor i memorialit është punuar i tillë, që kjo hapësirë të bëhet vendi i prehjes së amshueshme për 49 martirë të familjes Berisha, të vrarë më 26 mars të vitit 1999 në afërsi të po kësaj hapësire, e cila aktualisht nuk ka ndonjë trajtim meritore, por me këtë projekt planifikohet të shndërrohet si memorial muze, që në afërsi të së cilës gjithashtu, gjendet edhe lapidari i të gjithë martirëve civilë të komunës së Suharekës të vrarë, të masakruar, nga forcat paramilitare ushtarake e policore serbe gjatë luftës së vitit 1998/1999.

Më rastin e rivarrimit të mbetjeve mortore me 29 persona të gjetur deri më tani është startuar me fazën e parë të projektit, janë përgatitur hapësirat për varrimin edhe të 20 martirëve tjerë, që ende nuk janë gjetur dhe konsiderohen të zhdukur.

Edhe një herë, kërkoj në mënyrë publike përkrahjen e të gjithë deputetëve, pa dallim partie politike. Faleminderit!

KRYETARI: Do të thotë, deputeti Bali Muharremaj, 44, 43 e largoi, 44 e ka fjalën ministri i Financave.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Pajtohem që kjo çështje dhe ky projekt është shumë i ndjeshëm për familje dhe për të gjithë ne. Shuma që kërkohet është mjaft e madhe. Unë ju siguroj që edhe po ta kishim në këtë moment këtë shumë, shkon 6 muaj, shkon një vit, derisa të bëhet projekti, derisa të bëhen përgatitjet. Unë ftoj që deputeti ta tërheq këtë amendament, të kujdesemi me Ministrinë e Kulturës, me ministrin e Ambientit dhe me Agjencinë për memorialë, të përgatitet projekti dhe pastaj në rishikim ne mund ta shohim dhe ta fusim krejt shumën e nevojshme në bazë të projektit që përgatitet për këtë memorial. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Për hir të opinionit, i nderuar kryetar, unë falënderoj ministrin, mirëpo faza e parë ka përfunduar. Po qe se ka mundësi të hedhet në votim edhe një herë, le të varet prej deputetëve që janë në sallë.

KRYETARI: Do të thotë, kemi një situatë, kur deputeti Bali Muharremaj e ka amendamentin 44, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Qëndrimi i ministrit ishte në përkrahje e cila do të jetë e vazhdueshme në rishikim të Buxhetit. Kjo është situata aktuale, po gjithsesi ne po shkojmë në votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

70 deputetë kanë votuar. 23 për, 32 kundër, 15 abstenime. Amendamenti 44 nuk kalon.

Jemi në amendamentin 45, deputeti Danush Ademaj pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Urdhëro, i nderuar deputet!

DANUSH ADEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Amendamenti 45 ka të bëjë me, edhe pse nuk e ka marrë përkrahjen e komisionit, unë e shoh që ky amendament është dashur të kalojë nga komisioni, sepse nuk bën disbalancin e buxhetit, sepse veç e kemi drejtuar kërkesat kur të merren këto mjete veç janë të komuniteteve, që janë ndarë për komunitete dhe asnjëherë nuk shfrytëzohen për komunitete. Kemi kërkuar nga zyra e kryeministrit 300 mijë euro, që veç janë të dedikuara për komunitete e i shfrytëzon vetëm një komunitet. 400 mijë euro i kemi kërkuar nga Ministria e Kthimit që i ka 5 milionë euro e asnjëherë nuk shfrytëzon komuniteti ynë dhe 300 mijë euro i kemi kërkuar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, që duhet të shfrytëzohen për komunitete dhe këto asnjëherë nuk morëm përkrahje.

Unë nuk mendoj se këto do ta bëjnë disbalancën e buxhetit, por kërkojmë nga deputetët përkrahje në këtë amendament, sepse këto mjete janë për komunitete dhe janë të destinuara për komunitete e shfrytëzohen për tjera komunitete, kurse për komunitetin tonë është dashur deri më tani të vijë, së sot me një kërkesë këtu, edhe pse vazhdimisht kemi kërkuar nga kryeministri që të ketë kujdes për këtë komunitet, të përkujdeset pak më shumë, edhe pse kryeministri dhe shumë ministra i kanë vizituar komunitetet, ka pasur rastin ta vizitojë Fushë Kosovën, ka pasur rastin ta vizitojë, e kemi edhe një rast në komunën e Gjakovës vitin e kaluar kemi pasur rast që kanë vdekur fëmijë nga të ftohtit dhe ne kërkojmë që këto mjete, jo të bëhet disbalanci i buxhetit por të kërkohet, ndonëse këto mjete janë të dedikuara për komunitete.

Kërkojmë përkrahjen e të gjithë deputetëve. Unë besoj që s'do të kishim një disbalanc. Nëse e votojmë këtë buxhet, do t'i ndihmojmë familjet e varfra.

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Do të thotë, ne shkojmë... Danush Ademaj propozim amendamenti 45, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Faleminderit! 74 deputetë kanë votuar, 28 për, 37 kundër, 9 abstenime. Nuk kalon.

Deputetja Aida Dërguti pa përkrahjen e Komisionit Funksional, amendamenti 46. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar. 60 kundër, 5 abstenime, nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 47, deputeti Ali Berisha pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Urdhëro, i nderuar deputet.

ALI BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Nuk po flas për spitalin e Pejës, por po flas për spitalin e Gjakovës. Është një spital që dikur shëndetësia e Kosovës është krenuar me të, sot funksionon në kushte jo të mira. Është një spital që kryen shumë shërbime shëndetësore, është spital që ka distancën më të madhe prej Prishtinë dhe trajtohen shumë pacientë në atë spital dhe shumë reparte të atij spitali funksionojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira.

Është një amendament që është diskutuar edhe në Komisionin për Shëndetësi, besoj se do ta ketë përkrahjen edhe të Komisionit për Shëndetësi dhe kërkoj që të aprovet buxheti prej 500 mijë eurosh për investime në atë spital, në mënyrë që të krijohen kushte më të mira për funksionim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Propozimi i amendamentit 47 vjen nga deputeti Ali Berisha, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

76 deputetë kanë votuar, 25 për, 39 kundër, 12 abstenime, nuk kalon amendamenti 47.

Janë 5 amendamente nga Enver Hoti pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Amendamenti 48, 49, 50, 51, 52, shkojmë në tërësi. Zonja Bytyqi po e shoh reagimin, dëshironi lidhur me këto amendamente të flisni? Urdhëroni, fjala për ju!

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Unë fillimisht dua t'i përsëndes dhe t'i falënderoj kolegët e Komisionit për Buxhet dhe Financa për përkrahjen e dy amendamenteve, edhe pse pjesërisht, por kërkoj që edhe amendamentet tjera të hedhen në votim një nga një.

E pastaj e kemi amendamentin 49. Unë do ta lexoj amendamentin.

KRYETARI: Ju lutem, çdo amendament që ka ardhur është i obliguar të procedohet në këtë formë, pavarësisht. Urdhëro, zonja deputete, përfundoje!

SHUKRIJE BYTYQI: Unë e kam fjalën në emër të grupit. Unë isha edhe me zëvendësua kolegun Enver Hoti edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa pa të drejtën e votës, thash që i falënderoj kolegët deputet për përkrahjen e dy amendamenteve që kanë bërë, edhe pse jo në mënyrë të përgjithshme por pjesërisht. Amendamenti 49 është ndërtimi i transitit në Malishevë në vlerë prej 290 mijë eurosh, si kërkesë kjo e dorëzuar edhe në Ministrinë e Transportit më datën 11.02.2015, që është një projekt më se i nevojshëm, pasi që mundësia e lëvizjes normale të qytetarëve, sidomos nga automjetet transportuese që kalojnë nëpër Malishevë e vështirësojnë qarkullimin, prandaj mendoj se është më se e domosdoshme që Malisheva si qendër ta ketë një rrugë transit. Kërkoj votën e kolegëve deputetë.

KRYETARI: Faleminderit! Do të shkojmë me votimin amendament për amendament, një nga një.

Amendamenti 48, deputeti Enver Hoti, pa përkrahjen e Komisionit Funksional, votojmë tash. 72 deputetë kanë votuar, 13 për, 52 kundër, 7 abstenime. Nuk kalon.

Amendamenti 49, deputeti Enver Hoti, pa përkrahjen e Komisionit Funksional, votojmë tash. 74 deputetë kanë votuar, 15 për, 51 kundër, 8 abstenime. Nuk kalon.

Amendamenti 50, deputeti Enver Hoti pa përkrahjen e Komisionit Funksional, votojmë tash. 75 deputetë kanë votuar, 15 për, 49 kundër, 11 abstenime.

Amendamenti 51 dhe 52 u tërhoqën. A shkojmë në votim pra, s'ka nevojë, shkojmë në votim. Urdhëro, zonja Bytyqi!

SHUKRIJE BYTYQI: Amendamenti 51 dhe 52 e kanë marrë përkrahjen e Komisionit Funksional. Amendamenti 51 kërkesa për ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 50 mijë euro për kompleksin e varrezave të dëshmorëve të Brigadës 121 të UÇK-së, "Ismet Jashari-Kumanova" në Kleçkë. Kërkesa ka qenë 50 mijë euro, komisioni e ka përkrahur me 30 mijë euro dhe është e ndare edhe nënprogrami. Gjithashtu, edhe amendamenti 52 me kërkesën e deputetit Enver Hoti ka fituar përkrahjen e Komisionit Funksional. Domethënë, ne kemi kërkuar ndarjen e mjeteve buxhetore 30 mijë euro për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sheshit "Adem Jashari" në komunën e Malishevës, si dhe për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve në Malishevë. Edhe ky amendament e ka fituar përkrahjen e komisionit me 20 mijë euro.

Prandaj unë e kërkoj edhe votën e kolegëve deputetë, tani në sallë.

KRYETARI: Vetëm pak, zonja deputete, ka përkrahje nuk ka përkrahje dallon. E ka përkrahjen për atë shumë e cila ka kaluar, po ju tash po kërkon tjetër shumë. Ti as nuk po e tërheq, as nuk po e mban, si me ia bë? Urdhëro, urdhëro, vetëm sqaroje për deputetë, jo për mua.

SHUKRIJE BYTYQI: Kryetar, unë po e kërkoj përkrahjen, të paktën aq sa e kemi përkrahë në komision. E tërheq pra, shumë e kërkuar, falënderoj për përkrahjen që është dhënë në komision.

KRYETARI: A ka mundësi ta kemi një sqarim prej ministrit, se në qoftë se bie propozimi juaj, mos po bien edhe ajo që jeni marrë vesh.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Atëherë, vetëm pak, për hir të kolegëve deputetë një qartësim. Në amendamentet të cilat kanë qenë 28 kanë kaluar me shumën e paraparë nga Komisioni FunkSIONAL. Zonja deputete dëshiron që të njëjtat amendamente t'i fusë edhe një herë në votim me shuma të reja. A po i tërheq, a? Urdhëro, zonja deputete!

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit!

Jo, kryetar, se nuk më dëgjove deri në fund. Unë e tërheq shumë e kërkuar, por kërkoj votën për aq sa e ka përkrahur komisioni, se ashtu u morëm vesh.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja deputete, ka kaluar, ke parasysh, ka kaluar. Mirë është, në rregull, është qartësim, 51 dhe 52 tërhiqen në këtë formën në të cilën janë, për arsye se ka kaluar pjesën e amendamenteve me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 53, deputetët Luljeta Veselaj-Gutaj, Nezir Çoçaj dhe Enver Hoti, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëroni, zonja deputete, fjala për ju.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryetar!

E para është vërejtje që Enver Hoti nuk ka qenë pjesë e këtij amendamenti dhe kodi për amendamentin është shkruar gabim nga ana teknike e asistentëve, sepse është kodi buxhetor parashihet 20811116226118, do të thotë që i takon Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Kërkoj nga kolegët deputetë ta mbështesin këtë amendament, sepse ne duhet ta kemi parasysh sot kur flasim për shkolla, për objekte shkollore në parlament është diçka jo e mirë dhe nuk reflekton mirë. Me të vërtetë, gjendja e shkollës në fshatin Reçan të Suharekës është në gjendje të mjerueshme. Kërkoj mbështetjen e kolegëve deputetë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në amendamentin 53, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Zoti ministri e ka fjalën, para votimit.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Më lejoni të sqaroj se në bazë të ligjit Kuvendi nuk mund të vendosë që këto mjete t'i çojë në komuna.

Këtu është amendamenti që të ndahen mjete për ndërtimin e shkollës së re në Reçan, i shkojnë Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës në Suharekë.

Komunat e kanë buxhetin e vet të ndarë me 10% të buxhetit qendror me grante dhe këtë amendament teknikisht dhe ligjërisht në bazë të Ligjit të financave publike dhe Ligjit për menaxhimin e financave publike, kjo çështje nuk mund të votohet në Kuvend.

KRYETARI: Urdhëro, zonja deputete, fjala është përsëri për ju.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Fillimisht, zoti ministër, kërkoja ndryshimin e kodit dhe bartjen nga komuna në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

KRYETARI: Kjo mund të kalojë vetëm formalisht në votim, por forma si është paraqitur nuk ka realizueshmëri.

A ka mundësi ta fusim në votim, edhe pse ka parregullsi.

Amendamenti 53. Pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Votojmë tash:

Faleminderit! Kanë votuar 73 deputetë. 31 janë për, 35 kundër dhe 7 abstenime, nuk kalon amendamenti 53.

Kemi 3 amendamente nga deputetja Time Kadriaj: 54; 55 dhe 56, pa përkrahje të Komisionit Funksional.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Amendamenti 55, në fakt, është përfshirë nga komisioni dhe e tërheq këtë amendament.

Për shkak të përkrahjes së amendamentit 54, po e tërheq edhe amendamentin 56. Po mbetet vetëm amendamenti 54, që është asfaltimi i rrugës “Dëshmorët e Kombit” - manastir dhe kjo është i një rëndësie vitale. Ky projekt ka kohë që ka filluar, por asnjëherë nuk janë ndarë mjete të

mjaftueshme për realizimin e këtij projekti. Është i rëndësishë vitalë për shkak se mundëson edhe zhvillimin e turizmit dhe unë kërkoj nga deputetët ta përkrahin këtë amendament.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Time Kadrijaj i tërheq amendamentet 55 dhe 56, kurse tani do të votojmë amendamentin 54, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Më falni, e ka kërkuar fjalën zoti Haradinaj! Urdhëroni!

DAUT HARADINAJ: Nëse ka mundësi për vëmendje! E di se kur e pyeta ministrin për investime nëpër komuna, para se të shpërndahen nga komisioni, kanë qenë 24.000.000 euro.

Dhe, shpresoj që Drenasi me kryetarin e ri, Ramiz Lladrovci, të cilit i kisha uruar publikisht për fitoren, është ndarë i kënaqur, sepse vërtet ka përfituar jashtëzakonisht shumë dhe e përgëzoj dhe shpresoj që me fillimin e pranverës të jenë reale ato projekte.

Megjithatë, ky amendament, me të cilin ne po kërkojmë 100.000 euro shtesë, edhe kryeministri, edhe ish-kryeministri, edhe ministrat, edhe deputetët e dinë se po flasim për një zonë të mbrojtur, e cila tash e sa vjet është bërë një arenë beteje andejpari.

Dhe përfundimisht, pas 17 vjetësh kemi mbërritur që ta kalojmë manastirin e Deçanit me një, të themi, asfalt simbolik. Por, është një pasuri jashtëzakonisht e madhe, me interes nacional dhe nuk besoj se do të ishte një dëm i madh në rast se deputetët i japin përkrahje, sepse kushdo që e njeh atë pjesë, e di se është shumë me rëndësi dhe shuma është vetëm 100 000 euro.

Nuk mendoj se e rrezikon buxhetin e Kosovës një kosto prej 100 000 eurosh. Sido qo të jetë, ta lëmë në ndërgjegjen e deputetëve, por unë pres, sidomos nga ata që më kanë premtuar të votojnë për.

KRYETARI: Kisha lutur për vëmendjen! Ministri i Financave është në konsultim me kolegët e Qeverisë dhe përfundimisht do të shkojmë me votim.

Jemi te amendamenti 54 i deputetes Time Kadrijaj, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Kanë votuar 72 deputetë. 44 janë për, 20 kundër dhe 8 abstenime.
Miratohet amendamenti 54.

Shkojmë te amendamenti 57. Deputeti Hajdar Beqa, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Deputet, urdhëro!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Unë e thashë edhe në lexim të parë, po flas për një projekt me rëndësi të veçantë për qytetarët e 28 fshatrave, për furnizimin me ujë të pijes, ku ata qytetarë ende sot furnizohen me ujë të pijes nga pusët dhe ujërat sipërfaqësore, po flas për një projekt që është lidhur kontrata nga komuna e Gjakovës në vitin 2009 nga zoti Pal Lekaj dhe i cili projekt është realizuar diku rreth 40% dhe është imediate sot të përkrahet nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Është e pakuptimtë të flasim sot ende për ujë të pijes për zonën që ka dhënë shumë edhe për lirinë e vendit dhe për çdo gjë që ne po gëzojmë sot. Prandaj, kërkoj nga ana juaj që amendamentin 57 ta përkrahni. Unë e kam cekur ku të merren mjetet, pra të merren mjetet nga Ministria e Financave, në kodin 2900/0 të nenit 2 - kontingjenti për investime kapitale nga AKP-ja.

Të njëjtat mjete të barten në buxhetin, jo tash të Komunës së Gjakovës, se e pashë shpjegimin nga zoti ministër, por në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, në organizatën buxhetore 213, programi 22 500 - ujë dhe hedhurina. Kjo mund të realizohet në këtë formë juridikisht. Ministria e pranon dhe për këtë rast u konsultova edhe me Komunën e Gjakovës dhe Ujësjiellësin rajonal të Gjakovës për të bërë një memorandum mirëkuptimi dhe mund të realizohet në këtë formë pa pasur asnjë formë juridike.

Pra, kërkoj edhe një herë nga të gjithë deputetët, pavarësisht nga cila parti apo komunitet janë, ta përkrahin këtë projekt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Ministri i Financave e ka përgjigjen lidhur me këtë.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Ju njoftoj se amendamentet që u votuan me përkrahje të Komisionit, i gjithë kontingjenti që ka qenë për investimin në Ministrinë e Financave është shpërndarë për projekte kapitale. Pra, nuk ekziston më kjo shumë, sepse Kuvendi ka vendosur ta shpërndajë komplet atë pjesë të mjeteve. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti deputet, urdhëro!

HAJDAR BEQA: Kryetar dhe zotëri ministër, e shpjegova se kur të merren mjetet nga AKP-ja, nga këto mjete të merren, apo të gjejë formën Qeveria. Është çështje e Qeverisë, por unë e kam cekur shumë mirë në amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi një propozim të deputetit Hajdar Beqa, pa përkrahje të Komisionit Funkcional. Po ashtu e kemi sqarimin e ministrit të Financave, i cili tregon gjendjen buxhetore se nuk ka fond buxhetor. Urdhëro, Hajdar, edhe një herë, merre fjalën.

HAJDAR BEQA: E tha edhe ministri, por realisht ne po flasim për mjetet që derdhen në Buxhetin e Kosovës nga AKP-ja ose të gjendet një formë tjetër, sepse ka kod buxhetor dhe është shumë mirë në amendament i cekur.

(Ndërhyrje)

Është çështje e Qeverisë dhe mendoj se është kërkesë imediate, e premtuar gati nga të gjithë ministrat këtu dhe deputetët që kanë qenë në atë zonë, fiks që 17 vjet. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në votim.

Është amendamenti 57 i deputetit Hajdar Beqa, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, votojmë tash:

70 deputetë, plus 1 me dorë, kanë votuar, 30 janë për, 33 kundër dhe 8 abstenime. Nuk kalon amendamenti.

Amendamentet 58, 59 dhe 60. Deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kryeministër,

Falënderoj edhe Komisionin për Buxhet e Financa për arsye se propozimet që janë bërë nga diskutimi im janë pothuajse të përfshira, jo disa për shumën e kërkuar, por janë pjesë e këtij projektbuxheti, prandaj edhe amendamenti 58, tash vetëm se është ndryshuar, kur ka qenë restaurimi dhe konservimi i shtëpive muze në Lagjen Jasharaj nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe tash është zhvendosur si projekt te Agjencia për memoriale në Kosovë dhe është si projekt i bartur atje, e gjithashtu edhe amendamenti 59 për stadiumin olimpik “Adem Jashari” nuk është në shumën e kërkuar, por është inkorporuar në projektbuxhet me ndryshimet që i ka bërë komisioni.

Këto dy amendamente, 58 dhe 59, nuk ka nevojë të futen në votim, ndërsa kërkoj votën e deputetëve për amendamentin 60 për mbështetje për Odat e profesionistëve shëndetësorë dhe gjithashtu kërkoj që këto mjete të merren te nënkodi buxhetor i Agjencisë së Financimit Shëndetësor, te kodi buxhetor 10.9.59, te pajisjet mjekësore që janë të futura te shërbimet shëndetësore administrative logjistike, edhe ashtu Agjencia e Financimit Shëndetësor e ka për obligim dhe detyrim kontraktimin e shërbimeve shëndetësore, jo pajisjeve mjekësore, sepse

pajisjet mjekësore i kontraktijnë spitalet dhe Qendra Klinike Universitare. Edhe ashtu është gabimisht i adresuar si projekt këtui, dhe kërkoj mbështetjen tuaj që vërtet profesioneve shëndetësore t'u krijojmë hapësirë që nëpërmes odave, të cilat i kemi miratuar me anë të ligjit, pra Odave të profesionistëve shëndetësorë t'u mundësohet që të funksionojnë, të jenë në shërbimin e qytetarëve dhe të jenë edhe në shërbimin tonë, pra të jemi në shërbim të qytetarit dhe të punësojmë mjekë për të qenë në shërbimin e tyre.

Prandaj, kërkoj votën tuaj, sepse edhe është përcaktuar se ku mund të merren këto mjete buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë tërhiqen amendamentet 58 dhe 59 nga deputeti Bekim Haxhiu dhe ai kërkon votën për amendamentin 60, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Kanë votuar 72 deputetë. 24 janë për, 41 kundër dhe 7 abstenime. Nuk kalon amendamenti 60.

Para se të shkojmë në votimin e tekstit të projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara, i kemi edhe 2 amendamente, të cilat kanë kaluar, është gjithsej shuma prej 400 000 eurosh dhe ministri i Financave, nëse ka mundësi, të bëjë arsyetimin. Urdhëro, zoti ministër!

(Ndërprerje)

E ka fjalën ministri i Financave, dhe kërkoj vëmendje meqë ka implikime në tabelat financiare dhe futen ndryshime, të cilat mund të prekin shumë amendamente dhe përnjëherë të futen këto 400 000 euro për dy projekte, të cilat kanë kaluar.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Unë propozoj që për dy amendamentet që kaluan, një 300 000 dhe një 100 000 euro mjetet të merren nga Ministria e Financave nën Programi Administrata Qendrore me kod 11301, ndërtimi i objektit të ATK-së, Dogana, në Prishtinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë po e votojmë me aklamacion këtë pjesë. Kush është për? Ose, të shkojmë me vetëm kush është kundër?

Pra, a ka ndokush kundër kësaj pjese, sepse e keni parasysh është për varrezat e Mejës, si votim i kaluar.

A ka kush kundër?

Janë 3 kundër dhe 1 ka abstenuar.

Për janë të gjithë të tjerët! Kalon dhe aprovohet arsyetimi i ministrit.

Janë 83 deputetë në sallë dhe 79 deputetë kanë votuar për, kalon.

Tani shkojmë ta votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara, të përfshirë edhe miratimin e propozimit të ministrit për akomodimin e atyre fondeve për 2 amendamente, të cilat janë miratuar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash, projektligjin në tërësi.

77 deputetë kanë votuar në mënyrë elektronike, plus 1 me dorë, 78 deputetë. Pra, 69 plus, 1 me dorë, janë 70 për, 7 kundër dhe 1 abstenim, konstatoj se u miratua Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017. Urime!

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance plenare.

Mirupafshim në seancën plenare të sotme, në orën 11:00, kurse shqyrtimi i pikave të mbetura nga seancat e mëparshme do të bëhet para debatit parlamentar, në orën 15:00.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*